



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Maliq, më 26.07.2024

PROJEKT - VENDIM - NR. 6

Për

" Rishpërndarjen e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024 "

Në mbështetje të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqëverisjen vendore " neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, germa dh , ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 " përgatitja dhe miratimi i Buxheteve vendore " ,të ligjit Nr 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 45 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore", te ligjit nr. 97/2023 "Per buxhetin e vitit 2024", mbështetur në vendimin nr. 138 dt 26.12.2023 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit për vitin 2024 " Udhezimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024 'Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024 ", Shkresës së Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial me nr.11094 prot. datë 25.07.2024 "Mbi zbatimin e rregullave teknike në rritje të sigurisë elektrike" i kërkoj Këshillit të Bashkisë :

1-Të miratojë rishikimin e buxhetit për vitin 2024 si më poshtë :

**Pakësim**

Gr	Kap	Kod prog	llog ek	kodi	Objekti	vlera në lekë
00	05	04240	2315140	1680335	Blerje kamion vetshkarkues	488,000

**Shtesa :**

00	05	01110	2315130	1680311	Blerje automjeti(projekti bullgar)	183,838
00	05	01110	6029099	9999999	Pagese eksperti (projekti bullgar)	50,000
00	05	09120	602	9999999	Çertifikim i impiantit(rrjetit elektrik)	254,162

2.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë mbas miratimit.

Konceptoi : A.Muka

KRYETARI I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**

**Drejtoria e Financës dhe Buxheti**

**RELACION**

“Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore“

Të nderuar Këshilltarë !

Në mbështetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetqëverisjen vendore " neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, germa dh, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 "Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore ", të ligjit nr. 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore", neni 45 "Rishpërndarjene fondeve buxhetore", ligjit nr. 97/2023 "Per buxhetin e vitit 2024", mbështetur në vendimin nr. 138 dt 26.12.2023 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit për vitin 2024", Udhezimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", Bashkia Maliq në bashkëpunim me Ambasadën Bullgare ka lidhur Marrëveshjen e Bashkëpunimit për projektin e përbashkët me qëllim "Ofrimin e shërbimit në familje për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe fuqizimin e shërbimeve në Qendrën Komunitare Maliq" si dhe përdorimin e fondit me vlerë 25,500 euro si më poshtë ;

- Miratim fondi për "Investime" Blerje automjeti me vlerë 18,000 €
- Miratim Fondi për "Shpenzime Operative" (paketa ushqimore, materiale didaktike, karburant për transport, promocion etj ) me vlerë 7,500 €

Shërbimet që po mbulon ky projekt konstatojnë në :

1.Sigurimi i transportit të fëmijëve dhe prindërve nga banesa në qendër për të marrë shërbimin e nevojshëm ; Disbursimi i fondit nga euro në lekë do të bëhet me kursin e këmbimit të ditës së kalimit të fondit në llogarinë e thesarit për Bashkisë Maliq nga ana e Ambasadës Bullgare.

Fondet nga Ambasada Bullgare u levruan për dy vite,dhe nga konvertimi i euros në lekë (meqenëse kursi i këmbimit u ul) rezultoi diferencë si tek blerja e automjetit në vlerën 183,838 lekë dhe në shpenzimet operative për pagesë eksperti në vleren 50,000 lekë.prandaj kërkojmë ndryshim në buxhet për financimin e operatorëve ekonomikë për likuidimin e faturave.

- Fondi për certifikim të impiantve elektrike është kërkuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial me shkresë me nr.11094 prot. datë 25.07.2024 'Mbi zbatimin e rregullave teknike në rritje të sigurisë elektrike' si detyrim ligjor për të gjitha institucionet

Për këtë i drejtohem Këshillit Bashkiak të na miratojë këtë Projekt Vendim për rishikimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024.

Drejtor i financës dhe buxhetit

Almira MUKA

